

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Aramco Overseas Kompani B.V. (Aramco Overseas Company B.V.) me seli të regjistruar në Sheveningseveg 62-66, 2517 KH Hag, Holandë dhe EIG Menaxhment Kompani LLC (EIG Menagement Company, LLC), me seli kryesore në 600 Nju Hemshajr Avenju NW, Suit 1200, Uashington, DC 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përmes personit të autorizuar Bozhidar Millosheviqit avokatë nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 08.11.2023, merr këtë:

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Aramco Overseas Kompani B.V. (Aramco Overseas Company B.V.) me seli të regjistruar në Sheveningseveg 62-66, 2517 KH Hag, Holandë dhe EIG Menaxhment Kompani LLC (EIG Menagement Company, LLC), me seli kryesore në 600 Nju Hemshajr Avenju NW, Suit 1200, Uashington, DC 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të fitojë kontroll të përbashkët mbi MidOushn Holdings II L.P. (MidOcean Holdings II L.P.), një partneritet i kufizuar me zyrën e tij të regjistruar në 50 Lotian Roud, Festival Skver, Edinburg, EH3 9WJ, Mbretëria e Bashkuar ,edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më 16.10.2023, ndërsa e plotësuar më 24.10.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u

dorëzua një njoftim për përqendrim nga Aramco Overseas Company B.V. (Aramco Overseas Company B.V.) me seli të regjistruar në Sheveningseveg 62-66, 2517 KH Hag, Holandë dhe EIG Menaxhment Kompani LLC (EIG Management Company, LLC), me seli kryesore në 600 Nju Hemshajr Avenju NW, Suit 1200, Uashington, DC 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me anë të së cilit Aramco Overseas Kompani B.V. dhe EIG Menaxhment Kompani LLC do të fitojë kontroll të përbashkët mbi MidOushn Holdings II L.P. (MidOcean Holdings II L.P.), një partneritet i kufizuar me zyrën e tij të regjistruar në 50 Lotian Roud, Festival Skver, Edinburg, EH3 9WJ, Mbretëria e Bashkuar, (në tekstin e më tutjeshëm: "MidOushn Holdings II") dhe indirekt mbi MidOushn Enerxhi LLC (MidOcean Energy LLC), me zyrën e saj kryesore në 600 Nju Hempshajr Avenju NW, Suit 1200, Uashington, DC 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në tekstin e më tutjeshëm "Sipërmarrje e përbashkët e propozuar").

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Aramco Overseas Company B.V. është shoqëri e varur e cila është në pronësi të plotë të Saudi Aramco.

Aramco Overseas Kompani B.V. është një shoqëri e varur indirekte tërësisht në pronësi të plotë të Saudi Arabian Oil Kompani (Saudi Arabian Oil Company) me zyrën qendrore në kutinë postare 5000, Dahrn, 31311, Mbretëria e Arabisë Saudite (në tekstin e mëtejshëm: Saudi Aramco). Saudi Aramco është një shoqëri aksionare e krijuar me Dekretin Mbretëror nr. M/8 e Arabisë Saudite. Saudi Aramco është angazhuar kryesisht me kërkime gjeologjike, kërkime, shpim dhe nxjerrjen e substancave të hidrokarbureve dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe vendosjen në treg të këtyre substancave

Saudi Aramco nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut, por kryesisht është e angazhuar në Maqedoninë e Veriut në shitjen e polimerit.

EIG Menaxhment Kompani LLC- (së bashku me fondet e saj të kontrolluara dhe shoqëritë e lidhura me të – EIG), është një investitor institucional kryesor në sektorët globalë të energjisë dhe infrastrukturës, ai është i specializuar në investimet private në energjinë dhe infrastrukturën e lidhur me energjinë në nivel global.

EIG Menaxhment Kompani LLC dhe shoqëritë e lidhura me të (duke përfshirë subjektet që janë nën kontrollin e fondeve nën kontrollin e EIG) nuk kanë aktivitete investimi ose operacione biznesi në Maqedoninë e Veriut.

MidOushn Holdings II u themelua më 4 gusht 2023 për qëllimet e Transaksionit të Propozuar.

Ndërmarrja e përbashkët e propozuar është një shoqëri amerikane me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në vitin 2022 në shtetin e Delaver, aktualisht në pronësi të tërthortë nga fondet e kontrolluara nga EIG përmes MidOushn Holdings L.P. (MidOcean Holdings L.P.), një partneritet i kufizuar nga Skocia.

Ndërmarrja e përbashkët e propozuar është një shoqëri e gazit natyror të lëngshëm ("TPG") e krijuar dhe e menaxhuar nga EIG për të zhvilluar një portofol të larmishëm dhe të qëndrueshëm TPG që është gjithashtu konkurruese për sa i përket kostove dhe emetimeve të karbonit. Ajo pasqyron besimin e EIG në TPG si një faktor kritik në tranzicionin e energjisë dhe rëndësinë në rritje të TPG si një burim energjetik strategjik gjeopolitik. Ndërmarrja e përbashkët e propozuar synon të krijojë një portofol

sektorial (pure play) të larmishëm të integruar dhe ndërkombëtar të projekteve operacionale me cilësi të lartë dhe afatgjata për prodhimin e TPG.

Ndërmarrja e përbashkët e propozuar do të ketë aktivitete të orientuara nga tregu, duke blerë dhe shitur një pjesë të projekteve të palëve të treta të TPG-së në të cilat ajo ka investuar, fillimisht në Australi, potencialisht diku tjetër në një fazë të mëvonshme.

Ndërmarrja e përbashkët e propozuar aktualisht nuk posedon asnjë pasuri. Për më shumë informacion, shihni Shtojcën 3.

Në Maqedoninë e Veriut, Shoqëria e Përbashkët e Propozuar nuk ka pasur asnjë aktivitet deri më tani. Aktivitetet i saj i vetëm deri më sot kanë qenë lidhja e marrëveshjeve transaksionale për blerjen e mjeteve të TPG, të cilat ndodhen në Australi.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски